

INTERVISTË ME KREUN E PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI, AMBASADORIN ROBERT BOSCH

Botuar në revistën "Klan", më 21 mars 2009

Zoti Bosch, u bë pothuajse një vit e gjysmë që ju jeni në Shqipëri si Kryetar i Prezencës së OSBE-së. Çfarë përshtypjesh keni krijuar për politikën shqiptare?

Ju sigurisht e kuptoni se unë nuk dua të hyj mes debateve të hollësishme midis partive politike, aq më tepër që jemi vetëm pak muaj larg zgjedhjeve parlamentare. Kam parë me kënaqësi se gjatë periudhës që unë kam qenë këtu, partitë filluan të flasin e të bashkëpunojnë për të bërë të mundur reformat e nevojshme, çka përbën një zhvillim shumë pozitiv. Megjithatë, ajo çka ende më çudit janë shkëmbime shpesh të ashpra fjalësh mes kundërshtarëve politikë. Dhe për të ndryshuar pak temën, këtu politika ende dominohet në një masë të madhe nga burrat me ca përjashtime të vogla. Nuk është se dua të bëj ndonjë lidhje, por megjithatë, për momentin nuk shoh që të ketë një masë të madhe grash në poste drejtuese në arenën politike. Fakti që nga 140 deputetë vetëm dhjetë janë gra nuk është gjë e mirë. Unë besoj se mundësitë reale që gratë të përfaqësohen në politikë përbëjnë një tregues kyç për çdo demokraci moderne në lulëzim dhe si rrjedhim edhe një aspekt përbërës të procesit të demokratizimit në vend. Megjithëse është pa dyshim shenjë e mirë krijimi i një skeme gjinore 'nxitëse' për këto zgjedhje, na mbetet të shohim se sa seriozisht do ta marrin partitë politike 'arritjen rezultateve të duhura' në përmbushjen e detyrimeve të tyre demokratike dhe ndoshta edhe qytetare, në mënyrë që 50+% e popullsisë të mund të zërë një vend real në tryezën politike dhe të mos jenë kameriere që mbledhin pjesëza politike proverbiale. Le të shohim nëse kjo gjë do të realizohet me vepra dhe jo vetëm me fjalë. Ndërkohë që udhëheqësit e partive hartojnë listat paraprake të kandidatëve, do t'u bëja thirrje të gjithë drejtuesve të partive politike që të bëjnë përpjekje të fuqishme për t'u siguruar që shumë gra të forta dhe të afta brenda secilës prej partive të tyre, të kandidojnë në këto zgjedhje dhe të bëhen deputete – dhe nuk ka diskutim që gra të tilla ekzistojnë. Prezenca e OSBE-së sapo ka nisur një projekt për gratë në qeverisje. Ky projekt financohet nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta dhe Ambasada e Mbretërisë së Suedisë dhe do të zgjasë tre vjet. Projekti synon të promovojë udhëheqëset gra të të gjithë spektrit politik e më tej dhe të ofrojë një platformë që njëkohësisht të forcojë lidhjet në rrjet dhe të nxisë reagimin e autoriteteve publike ndaj çështjeve të gruas.

Paraardhësit tuaj nuk kanë pasur marrëdhënie të lehta me politikanët shqiptarë dhe kanë pasur situata të vështira dhe zgjedhje të cilat janë kontestuar. Si i keni ju marrëdhëniet me ta dhe pse mendoni se ka ekzistuar një pakënaqësi e tillë kundër OSBE-së në të shkuarën?

Që të jem i sinqertë, nuk jam shumë i interesuar që të flas për të shkuarën, megjithëse më duket se ekzagjeroni pak. Ajo për çka mund të flas është e tashmja dhe e ardhmja. Për sa më përket mua, marrëdhëniet tona me aktorët kryesorë në vend të të gjitha palëve – si të djathtë dhe të majtë – janë jashtëzakonisht të forta. Në bisedojmë sistematikisht dhe më pëlqen të mendoj se gëzojmë një marrëdhënie të hapur dhe tejet miqësore. I vetmi interes që unë kam është që ta shoh Shqipërinë të ecë përpara me procesin e saj të reformave dhe, veçanërisht në muajt vijues, të shoh që zgjedhjet parlamentare të mbahen sipas standardeve ndërkombëtare, në mënyrë që Shqipëria të mund të mbyllë përfundimisht kapitullin e zgjedhjeve jocilësore.

Në opinion publik ekziston përshtypja se zyrtarët e komunitetit ndërkombëtar në Tiranë shpesh i ekzagjerojnë problemet e vendit, kur u raportojnë shefave të tyre me qëllim që të

zgjasin qëndrimin dhe rrogat e tyre, të cilat nuk do të kishin mundësi t'i merrnin në një vend 'normal'. Sa problematike apo 'e rrezikshme' është në të vërtetë Shqipëria?

Edhe unë do të dyshoja shumë nëse kjo është vërtet pikëpamja reale e publikut kundrejt komunitetit ndërkombëtar. Në fakt, unë ndonjëherë kam dëgjuar të kundërtën – që ne shpesh jemi tepër "të butë". Si organizatë ndërkombëtare, ne vëzhgojmë dhe asistojmë dhe në raportet tona e vlerësojmë progresin e arritur, por konstatojmë edhe fushat që kanë nevojë për më shumë vëmendje, dhe këto të fundit tërheqin kryesisht gjithë vëmendjen, pasi lavdërimi ka më pak 'vlerë' si lajm sesa kritikën pozitive. Për sa i përket pyetjes se sa problematike apo e rrezikshme është Shqipëria, do të thoja se pikësëpari në vend që të flasim për 'probleme' apo 'rreziqe', duhet të flasim për sfida. Do të thosha se ndryshe nga, le të themi, 10-11 vjet më parë, është më se e dukshme se Shqipëria ka ecur përpara me hapa viganë. Tashmë ky është një tjetër vend, prandaj u duhen njohur plotësisht meritat të gjitha qeverive që kanë rivendosur stabilitetin gjatë kësaj periudhe dhe që kanë çuar përpara procesin e reformave. Sfidat kryesore qëndrojnë tek zhvillimi i mëtejshëm i institucioneve demokratike dhe tek garantimi i ruajtjes dhe i forcimit të mëtejshëm i ndarjes së plotë të pushtetit midis ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit.

Jemi më pak se katër muaj para zgjedhjeve të ardhshme të 28 qershorit. Çfarë duhet të bëjë më shumë qeveria me qëllim që të garantojë mbajtjen e zgjedhjeve sipas standardeve ndërkombëtare?

Pikësëpari, lexuesit tuaj duhet të jenë informuar se në Tiranë ka ardhur për vizitë një Mision i OSBE/ODIHR-it për Vlerësimin e Nevojave dhe se ai është takuar me aktorë vendas me qëllim që të vlerësojë situatën parazgjedhore. Në kohën e duhur do të shohim edhe mbërritjen e një Misioni afatgjatë të ODIHR-it, kurse më vonë do të shohim një numër të madh vëzhguesish afatshkurtër. Për t'i ardhur në ndihmë medias së gjerë shqiptare dhe publikut në përgjithësi, është e rëndësishme të theksohet se pyetjet specifike që lidhen me përgatitjen e zgjedhjeve dhe vëzhgimin e këtyre zgjedhjeve duhet t'u drejtohen OSBE/ODIHR-it dhe misionit të monitorimit që do të vijë. Pra, që t'i përgjigjem pyetjes suaj më në përgjithësi, do të thosha se si qeveria, ashtu edhe opozita, së bashku, kanë një rol të rëndësishëm për garantimin e përmbushjes së standardeve ndërkombëtare për sa i përket zgjedhjeve të qershorit – sidomos për sa i përket krijimit të besimit të publikut tek ky proces. Mendoj se Komisioni i Posaçëm ndër-partiak i ngritur së fundmi për monitorimin e përgatitjeve për zgjedhjet, është qartësisht një lëvizje pozitive në këtë aspekt. Këshilla, apo, le të themi, inkurajimi më i mirë që unë mund të jap është që të gjithë aktorët vendas të respektojnë Kodin Zgjedhor dhe ta lënë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të vazhdojë të bëjë punën e vet, pa ndërhyrje politike apo ndërhyrje të ndonjë lloji tjetër. Ata, sigurisht, që duhet të veprojnë në përputhje si me përmbajtjen, ashtu edhe me frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor, dhe ligje të tjera që rregullojnë procesin zgjedhor. Më lejoni, gjithashtu, të them se kjo do të thotë se partitë duhet t'i rezistojnë tundimit për t'u përpjekur që të ndikojnë se si ju, gazetarët, të bëni punën tuaj.

Procesi i kartave të identitetit duket sikur është më i ngadaltë sesa parashikohej. Si e shikon OSBE-ja këtë proces dhe a keni besim se populli shqiptar do t'i hedhë përfundimisht pas krahëve problemet me zgjedhjet?

Siç thashë edhe më sipër, gjithçka që unë mund të bëj është që të shpresoj se shqiptarët do të jenë përfundimisht në gjendje që t'i lënë përfundimisht pas problemet e zgjedhjeve të mëparshme. Megjithatë, në fund të fundit, kjo kuptohet që do të varet shumë nga aftësia e aktorëve vendas të përfshirë në këtë proces për ta bërë punën e tyre siç duhet. Megjithëse ne nuk kemi luajtur ndonjë rol në procesin e kartave të identitetit e as nuk kemi ndonjë përgjegjësi për të, e ndiej se duhet të

paktën t'i inkurajoj gjithë aktorët vendas që ta çojnë përpara procesin e administrimit të zgjedhjeve. Gjithë aktorët vendas e kanë për detyrë të garantojnë marrjen e vendimeve më të mira dhe që zgjedhjet e ardhshme të mos kthehen në një tjetër "mundësi të humbur". Parakushtet janë ende të favorshme që këto zgjedhje të bëhen 'zgjedhje për t'u shënuara' dhe unë vërtet besoj se që të gjithë ata që janë të përfshirë në proces janë mëse të aftë të kujdesen që këto zgjedhje të jenë vërtet të tilla. Më lejoni të jem më i qartë – ka ende kohë për të prodhuar karta identiteti dhe pasaporta biometrike të mjaftueshme, me qëllim që zgjedhjet të mbahen pa problemin e mospasjes së një dokumenti të vlefshëm për të votuar. Unë jam i sigurt se qeveria po punon shumë ngushtë me kompaninë e kontraktuar për prodhimin e kartave të identitetit për ta garantuar këtë. Kam, gjithashtu, besim se të gjitha njësitë e pushtetit vendor do ta bëjnë siç duhet punën e tyre, pavarësisht ngjyrimeve politike, për garantimin e një procesi pa pengesa. Përveçse do t'i inkurajoja të gjithë shqiptarët që kanë nevojë për kartë identiteti që të aplikojnë e ta marrin atë, çfarë do të sugjeroja unë për përmirësimin e këtij procesi? Do të ishte mirë që të shihnim një intensifikim të konsiderueshëm të fushatës së ndërgjegjësimit publik, në mënyrë që më në fund të shohim që publiku të jetë më aktiv në aplikimin për karta identiteti. Vetë qytetarët duhet të jenë vërtet më aktivë si për të aplikuar për karta identiteti, ashtu edhe për të parë listat paraprake të zgjedhësve, të cilat janë publikuar tashmë në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme, janë afishuar pranë zyrave të gjendjes civile të njësive të pushtetit vendor, si dhe pranë qendrave të caktuara të votimit.

Ndërkohë, gjatë miratimit të Kodit Zgjedhor, në vend u ndez debati politik. LSI-ja dhe parti të tjera më të vogla kundërshtuan paktin PD-PS për Kodin. Si e shihni këtë kod zgjedhor dhe a do të jetë i nevojshëm rishikimi i tij? Dhe nëse po, cilat do të ishin ato pjesë?

Pati një debat politik mes aktorëve vendas gjatë të cilit edhe unë bëra disa komente publike. Megjithatë, në fund, Kuvendi shqiptar mori një vendim, i cili u dekretua më pas nga Presidenti. Për sa më takon mua, ky ishte fundi i kësaj çështjeje. Do të thosha se të pasurit e një debati mbi dicka të kaluar tani, kaq afër zgjedhjeve do të shërbente vetëm për të na shpërqendruar nga çështje të rëndësishme që kemi në dorë – konkretisht, garantimi i mbajtjes së zgjedhjeve në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare. Për atë që mbetet, mund t'i referohem vlerësimit të Komisionit të Venecias së Këshillit të Evropës /ODIHR-it për Kodin, i cili do të publikohet së shpejti. LSI-ja dhe të gjitha ato parti të vogla që ndihen të zhgënjyera nga qëndrimi ynë e dinë shumë mirë se dera ime dhe ajo e Prezencës është gjithmonë e hapur për ta, ashtu siç është për të gjitha partitë politike.

Një tjetër çështje e rëndësishme ka qenë ligji për pastrimin e figurave, për të cilin OSBE-ja ka folur e ka pasur vërejtjet e veta. A duhet të rishikohet ky ligj, sipas jush, para se të miratohet? Çfarë cenon ky ligj? Si duhet të veprojë qeveria me qëllim që të ketë një ligj të plotë për një çështje kaq delikate?

Që ta themi thjesht, unë besoj se ky ligj ngre vërtet një shqetësim të madh si nga ana procedurale, ashtu edhe nga ajo e përmbajtjes. Duhet të ishin zhvilluar patjetër konsultime shumë më të gjera politike dhe publike para miratimit të këtij ligji. Kjo ishte edhe arsyeja se pse ne e inkurajam qeverinë në mënyrën më të fuqishme të mundshme që t'i rishikonte pasojat ligjore dhe politike të ligjit dhe i kërkua që të ftonte disa ekspertë për ta parë atë. Ashtu siç e kam thënë edhe më parë publikisht, unë nuk jam kundër një ligji të tillë, por ai duhet të jetë në përputhje me shtetin e të drejtës dhe dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë dhe duhet të respektohen plotësisht standardet e pranura ndërkombëtare. Thjesht do të dëshiroja t'u kujtoja të gjithëve Konkluzionet e Këshillit Evropian të dhjetorit të shkuar, ku BE-ja theksoi rëndësinë e shtetit të së drejtës dhe

pavarësisë së gjyqësorit si pjesë të kriterëve politike për hyrjen në BE. Ne tani e dimë se Gjykata Kushtetuese e ka pezulluar zbatimin e ligjit derisa ajo të dalë me një qëndrim përfundimtar. Mendoj se Gjykata duhet përgëzuar për mbajtjen e këtij qëndrimi. Megjithëkëtë, ndihem i sigurt se të gjithë aktorët politikë do të kujdesen për ta respektuar solemnisht këtë vendim gjykate, ashtu siç do të kujdesen për respektimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës. Çdo koment publik nga aktorët vendas apo ndërkombëtarë gjatë kësaj periudhe të ndërmjetme mund të shihet vetëm si një ndërhyrje e panevojshme dhe e padëshiruar në një proces të rregullt ligjor, dhe ajo çka është më e rëndësishme, në ndarjen kushtetuese të pushteteve. Mendoj se të gjithë e dinë se komuniteti ndërkombëtar si këtu, ashtu edhe në kryeqytetet evropiane po e ndjek me shumë vëmendje këtë çështje. Pa paragjykuar vendimin e Gjykatës, ashtu si Këshilli i Evropës dhe BE-ja, edhe ekspertët e OSBE-së janë të gatshëm t'u ofrojnë këshillim dhe asistencë autoriteteve shqiptare në gjetjen e mënyrave për arritjen e objektivit të ligjshëm të trajtimit të së shkuarës, në përputhje të plotë me standardet aktuale përkatëse vendase dhe ndërkombëtare.

Pak muaj më parë Qeveria krijoi një problem “artificial” me Prokurorinë. Sipas mendimit tuaj, cilat ishin shkaqet që çuan në këtë konflikt? A mos e kufizon gjë veprimtarinë e prokurorisë Ligji mbi Prokurorinë i hartuar nga Ministria e Drejtësisë?

Nuk besoj se dëshiroj t'i futem një diskutimi të hollësishëm të faktit nëse u krijua një problem “artificial” me Prokurorinë ose jo. Kjo është analiza juaj e kësaj çështjeje, të cilën ju natyrisht keni të drejtën tuaj ta bëni. Unë do t'i përgjigjesha pyetjes suaj si më poshtë. Mendoj se ligji sjell disa përmirësime në strukturën e Prokurorisë, duke ngritur ndërkaq disa pyetje të rëndësishme rreth ndërhyrjeve të mundshme të degëve të tjera të qeverisë mbi këtë institucion në thelb *gjyqësor*. Edhe pse shumë prej ndryshimeve të miratuara rishtazi mund të shërbejnë për përmirësimin e kornizës ligjore për ndjekjen penale, ka edhe disa të tjera që mund të keqpërdoren nga Kuvendi, duke vënë kështu në rrezik pavarësinë e prokurorisë në të ardhmen. Një shqetësim tjetër është koha e pamjaftueshme që u vu në dispozicion për mbajtjen e konsultimeve publike rreth ligjit të ri, duke pasur parasysh që ligji u depozitua në Kuvend më 10 dhjetor 2008 dhe u miratua më 29 dhjetor 2008. Megjithëkëtë, kritikata e bëra nga prokurorët për heqjen e imunitetit të tyre dhe procedurat e ankimit për masat disiplinore duket se janë kryesisht të pajustificuara.

Flitet shumë për reformat në sistemin gjyqësor, por nuk është bërë shumë në këtë drejtim. Çfarë ndihme mund të ofronte OSBE-ja në këtë drejtim dhe si e vlerësoni performancën e qeverisë në lidhje me përparimet e bëra në procesin e reformave?

Duhet të jetë e qartë, pikësepari, se procesi i reformës gjyqësore mund të dalë me sukses vetëm në qoftë se në të luajnë një rol të plotë edhe aktiv shumë sektorë të shoqërisë. Ja pse nuk është aspak e dobishme po të shprehemi se ky apo ai institucion nuk ka pasur një performancë të mirë në këtë drejtim. Për mua është e qartë se procesi i reformës gjyqësore nuk ka përfunduar ende, dhe mendoj se ka pak gjasa që ky proces të mbyllet përpara zgjedhjeve. Mendoj se Raporti i Progresit për Shqipërinë i Komisionit Evropian për vitin 2008 ua bëri të qartë të gjithë aktorëve vendas se “Procedurat gjyqësore ende mbeten të ngadalta dhe shfaqin mungesë transparence”. Pra, besoj se mesazhi është i qartë. Në realitet, masa të tilla si i shumëdiskutuari Ligj për Pastrimin e Figurave mund të shihet si një ligj që mbart rreziqe për pavarësinë e gjyqësorit dhe prokurorisë. Duhet të hyjnë në rrugën e zgjidhjes edhe shumë elementë të tjerë të procesit të reformës gjyqësore, me qëllim që drejtësia të bëhet më e paanshme dhe më transparente. Për shembull, korrupsioni brenda gjyqësorit duhet luftuar sa më shpejt dhe me sukses. Që ta përsëris dhe një herë, një reformë gjyqësore e vërtetë dhe domethënëse nuk ka të bëjë vetëm me rishkrimin e të ashtuquajturave ligje organike që rregullojnë veprimtarinë e organeve gjyqësore.

Pra, ajo çka është më e rëndësishme është të shohim se si funksionojnë këto organe në praktikë. Me fjalë të tjera, deri në çfarë mase zbatohen ligjet procedurale? Madje në çfarë mase është i mundur edhe zbatimi i tyre? Sipas mendimit tim, nëse ligjet nuk zbatohen, atëherë ose vetë ligjet duhen ndryshuar, ose gjyqtarëve, prokurorëve dhe të tjerëve u duhet dhënë një shtytje e mirë me qëllim që të fillojnë e t'i zbatojnë ato siç duhet. Diçka tjetër që duhet pasur parasysh është që kjo nuk është thjesht çështje e ndryshimit të strukturave organizative brenda këtyre organeve. Po t'i shohim çështjet nga ky këndvështrim, do të thotë se e kemi keqkuptuar mbarë procesin e reformës. Problemi i vërtetë i gjykatave dhe prokurorive nuk qëndron në individët e punësuar pranë këtyre institucioneve apo mbikëqyrësit e tyre, por qëndron në mënyrën si sillen ata gjatë përgatitjes së proceseve gjyqësore dhe gjatë gjykimeve. Nuk mjafton më thjesht qasja e të konsideruarit 'detyrë e kryer' e cila është përdorur në vitet e kaluara. Kështu që mesazhi im i thjeshtë është "zbatim, zbatim, dhe përsëri zbatim".

Objektivi kryesor i reformës sonë gjyqësore qëndron në dhënien e ndihmesës autoriteteve vendase për nxitjen e funksionimit të duhur të sistemit ligjor. Për shembull, ne kemi nxjerrë një analizë të gjerë të sistemit ligjor në të cilin përfshihen rekomandime për reformë dhe mënyrat si mund të ndihmojmë për zhvillimin e institucioneve ligjore, e veçanërisht të gjykatave, prokurorive, noterive, zyra të përmbartimit dhe avokatëve. Për të përmirësuar njohjen dhe zbatueshmërinë e standardeve të etikës gjyqësore, kemi nisur një numër projektesh me objektiva të qarta. Projekti për Zhvillimin e Gjyqimit të Drejtë po ndjek dhe analizon punën e gjykatave dhe prokurorisë, si dhe atë të policisë, në atë që ka të bëjë me arrestimet dhe hetimin e veprave penale. Analiza u bë nga prizmi i standardeve vendase dhe ndërkombëtare për gjykimin e drejtë dhe më pas u botua në formën e raporteve që përfshinin rekomandime konkrete për përmirësimin e procesit. Kështu që, për ta përmbledhur, besoj se Prezenca po punon pa u lodhur së bashku me institucionet e tjera ndërkombëtare, për ta ndihmuar vendin në procesin e reformës gjyqësore.

Së fundi, Komisioni i Venecias ka dalë me një opinion rreth ndryshimeve kushtetuese të 21 prillit 2008, duke i konsideruar ato në përputhje me ligjin. Çfarë mendoni ju për këtë?

Nuk është praktikë normale që të bëjmë komente publike rreth raportit të një institucioni tjetër ndërkombëtar. Siç e dimë të gjithë, Komisioni i Venecias është një ndër strukturat më të respektuara të Këshillit të Evropës dhe kemi besim të plotë se ata do të dalin gjithmonë me opinione të shëndosha ligjore. Megjithatë, ia vlen t'u kujtohet të gjithëve se Komisioni i Venecias thjesht deklaroi se ndryshimet kushtetuese nuk përbënin ndonjë shkelje të standardeve evropiane. Sidoqoftë, ky organ shprehu shqetësimet e tij rreth shpejtësisë së kryerjes së procesit dhe disa prej ndryshimeve, e posaçërisht të atyre që kishin të bënin me Nenin 149 mbi Prokurorin e Përgjithshëm.

Krahas zgjedhjeve dhe gjyqësorit, organizata juaj trajton edhe çështjet e medias. A keni ndonjë gjë për të vënë në dukje në lidhje me situatën e medias në vend dhe atë se çfarë po ndodh sot në tregun mediatik?

Besoj se qeveria dhe institucionet e tjera shtetërore kanë për detyrë të garantojnë një kornizë ligjore në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke e lënë pas kësaj tregun që të përcaktojë pjesën dhe peshën e tyre brenda tij. Për këtë qëllim, duhet që Shqipëria të azhurnojë kornizën e saj ligjore për radio dhe televizione dhe ta përfaqëzojë atë me standardet e BE-së. Njëherazi, vendi do të ballafaqohet me sfidën madhore të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike. Çfarë ka ndodhur deri më tani? Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka hartuar një strategji për këtë qëllim, e cila me mbështetjen tonë u diskutua me komunitetin e medias, ndërsa Zyra e

Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave paraqiti komente me shkrim. Ndonëse mendoj se ky projekt strategji është i mirë dhe solid, mbetet ende shumë punë për t'u bërë me të dhe me median, si dhe duhen intensifikuar konsultimet me publikun dhe me ekspertët e fushës. Cështjet e ligjit dhe strategjia janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Nuk ka shumë kuptim që të hartohet një ligj i ri për median, i cili nuk përmban në vetvete një kornizë për dixhitalizimin. Kohët e fundit, KKRT-ja dhe Prezenca zhvilluan një seminar me aktorët e rëndësishëm vendas, ku u vendos që të krijohej një Task Forcë me detyrën për ta çuar përpara procesin e dixhitalizimit. Që ky proces të jetë i suksesshëm, nevojitet angazhimi i vazhdueshëm i Qeverisë dhe Kuvendit për avancimin e këtij procesi, por edhe një angazhim konkret për përballimin e faturës financiare që do të nevojitet për një projekt të tillë kaq ambicioz. Vetëm atëherë, dixhitalizimi do të mund të forcojë vërtetë pluralizmin dhe lirinë e medias. Po ashtu, unë besoj se është e rëndësishme që t'i krijohen kushte shërbimit transmetues publik për ta përmbushur mandatin e tij në pavarësi të plotë. Edhe kjo duhet pasqyruar në çdo ligj të ri dhe gjatë hartimit të strategjisë.

Fund